

HAZIS NDREU



BIBLIOTEKA
SHITETIT

814-7


N 33

ORDINANC

814-7
N 35.

HAZIS NDREU

ORDINANCI



20424

Satira

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KY VËLLIM ME SATIRA POPULLORE
FITOI ÇMIM TË TRETË NË KONKURSIN LE-
TRAR-ARTISTIK TË 30-VJETORIT TË ÇLIRI-
MIT.

ORDINANCI

Xhetan Xheta i Xhet' Xhetanit.
Lindë n'malësi, në majë t'malit,
Gjyshi e baba fukara,
Me zor jetën tue e ça,
Dimën e verë t'u u përpjekë,
Për me hapë një shteg në jetë.
Por në kohë t'Naltmadhnisë,
S'kishte shteg për djem t'Malsisë.
Tetëmbëdhjetë kur mbushi trimi,
I çoi letër rekrutimi.
Dhe, një natë, në terr pa hanë,
E pa vetën në Tiranë,
Në mëngjes, kur ra buria,
U rreshtue kompania,
Dhe toger Bablosh Babluçi,

Të dy thembrat bashkë i puqi.
Repartit i dha komandë:
— Kompania! Eja n'radhë!
Pse zbardh dhambët, or gomar,
Mos kujton se je te shtëpia?
Je ushtar te Naltmadhnia!
— Hej toger, mor, tungjatjeta,
T'paraqitet Xhetan Xheta
Dje u ndava me tërqote,¹
Ke selam nga nana jote.
Dhe Babloshi siç qe ngreh,
Dëgjoi fjalët edhe u shkreh.
— Pa dëgjoni, more ushtarë,
A e shikoni këtë tutkun?
Jemi të dy nga një katund,
Ban shakara me zarar.
E qysh sot, pra ju ta dini,
Ky asht bash si Nastradini,
Gjithnji fshati e ka dashtë,
E ka hedhun e përdredhun,

1) lopatë



Pak shkollë bani me të vjedhun,
Me që jemi prej një kepi,
Ordinancë do e mbaj pas vedi.
Meqë s'kam shkollë e kalem,
Sekretar vet do ta kem.

II

Po s'shkoj shumë veç disa muej,
Ordinanci nga malsia,
Për asgjë ma s'ishte i huej,
T'gjitha i kryente ç'donte shtëpia.
Mjaft i mprehtë kishte qëllue,
Me ia hedhë drejt mallkue,
Dhe togeri, burrë kaba,
Mbas tij u bante kalama,
Fikej gazit, shuente fare,
Gjith ai zdap as për një parë.
Po, sa herë shkrihej togeri,
Ai Xhetani përnjiheri,
Drejt përdrejt ose si n'shpinë,
Zhele bante tani parinë,

Tallte hollë dhe Naltmadhninë.
Ishte bir i fukarasë,
Bante luftë në majë t'shakasë.
Po togeri nga inati
Na krekosej si kaposh.
Ia ndërpriste n'çast Xhetani
— Me shaka e kam, Bablosh!
Ty t'ngel hatri për do gjana,
Që shumëkush ato edhe i di.
Ja, për shembull, kur më çove,
Me shërbim në derë t'Oborrit,
E dëgjova me këto veshë:
«Mbreti asht në buzë të vorrit!»
«Pse — e pyeta — more zotni,
Nga e dini gjendjen e mbretit?»
«Çfarë bahet në krye t'Oborrit,
S'i shpëton kollaj miletit.
Naltmadhnia ditën e fundit
Bash kapak i vu tradhëtisë,
Shiti vendin Italisë.»
Na u nxeh Bablosh Babluçi
Si me i l'shue shpuzë prushi:

— Kush ka qenë ai dindushman¹⁾,
Që guxoi me folë ksisoj?
M'thuej emnin e qafirit,



1) Tradhëtar i fesë.

Se njitash po e arrestoj!
— Mos u lodh, bre lum kumbara,
Mos u skuq, zotni Bablosh,
Se bash dreqin t'kesh me vetë,
Kurrë s'mundesh ta takosh,
Se ai njeri syshkëndi,
Që i qanë hallet popullit
Po vepron n'Oborr të Zogut».
Ujë i ftohtë i ra Babloshit,
Mengadalë u shtri në shtrat,
I djersitun turfulloi:
— Ruejna, zot, ndoj taksirat!
— Pa dëgjo, zotni toger,
Po bajmë llaf si «mik me mik».
Unë e di se je i «ashpër»,
Të lutem, mos u ban nevrik.
Sot, kur dola në pazar,
E dëgjova nji tue thanë,
Se e shoqja e Zogut t'Parë,
Kishte mbetun, mor shtatzanë.
Po i leu djalë maxharistanes¹⁾

1) Hungarezës.